

Turgut Özal

BULETIN

KLUBI "SHPRESA"

Programet Festive

Eskursione



Në hapat e suksesit !

Klubi i Medias

Erjon Saliasi
Erjona Saqe
Imelda Prençe
Irma Derjaj
Fatbardha Gjura
Albana Çorja

Kayceety Mullaj
Kristina Karabashi
Alba Goskova
Nikol Kaso
Xhesi Nurellari
Zenel Abedin Vogli

Designer
Dorjan Pitani

ADRESA

Rruga "Bernardin
Palja", Ndërtesa
15, Hyrja 1, Njësia
Bashkiake Nr.6, Ti-
ranë – Shqipëri

TEL: +355 42 486-
666 FAX: +355 42
486-666 E-MAIL:
info@turgutozal.edu.
al

Misioni i një shkolle është edukimi dhe formimi i nxënësve të saj për t'i bërë ata qytetarë të denjë të vendit dhe të botës. Të mësuarit ose të nxënët, pa dyshim që është parësori në këtë mision, ndaj në shkollën tonë synohet dhe praktikohet mësimdhënia me në qendër nxënësin. Në mënyrë që të mësuarit të jetë sa më i shpejtë, por në të njëjtën kohë logjik dhe i qëndrueshëm, në shkollë organizohen shpesh veprimtari praktike, projekte, vëzhgime të botës reale, mundësuar kjo edhe me anë të internetit dhe botës digjitale. Çdo vizitë, eksperiment, shëtitje, takim apo bisedë është kryer në funksion të të mësuarit duke e kthyer atë në një mësimdhënie efektive dhe nxënie të prekshme.

Por për të qenë një qytetar i denjë nuk mjaftojnë vetëm dijet, ndaj shkolla jonë synon të zhvillojë te nxënësit aftësitë e pjesëmarrjes qytetare dhe përfshirjen e tyre të vetëdijshme në zgjidhjen e problemeve të komunitetit ku bën pjesë. Thënia e njohur e Nënë Terezës "Ne nuk mund të bëjmë gjëra të mëdha, por mund të bëjmë gjëra të vogla me dashuri të madhe", është aktuale edhe sot e kësaj dite. Thënie të tilla, nxënësit e shkollës sonë jo thjesht i dëgjojnë apo i lexojnë diku, por mbi të gjitha i vënë në jetë. Pikërisht, nxitur edhe nga veprimtaria e klubit "Shpresa", të gjithë nxënësit, duke nisur që nga grupet e kopshtit e deri te klasat më të larta, kanë dhënë kontributin e tyre në shenjë solidariteti për fëmijët të cilët jetojnë në familje me vështirësi ekonomike. Me ndihmat e mbledhura janë dhuruar: ushqime, mjete shkollore, libra jashtëshkollore, lodra apo edhe karrige për fëmijët me aftësi të kufizuara. Mbi të gjitha, në çdo rast, nxënësit e shkollës sonë dhuruan buzëqeshje, pasi çdo dhurim ishte një vepër dashurie.

TURGUT ÖZAL

19

TIRANA

1. KLUBI "SHPRESA"

2. Shembull Për T'u Ndjekur, Nora Malaj

3. Ministri Panariti në Panairin e Klubit "Shpresa"

4. Panair në Ministrinë e Bujqësisë

5. Një Karrige Për Luizin

6. Fëmijët me Aftësi Të Kufizuara

7. Klubi Shpresa Ndhma në Zallbstar

8. Buzëqeshje Për Jetimët

9. Një Libër Për Mikun Tim

10. Miqtë e Librit

11. Panairi i Librit

12. Vizitë në Bibliotekën Kombëtare

13. Nxënësit në Ministrinë e Integrimit Evropian Ministria, Ju Jeni e Ardhmja e Këtij Vendi

14. Vizitë në Bashkinë e Kamzës

15. Vizitë në Kuvend

16. Muaji i Artit dhe Letërsisë

17. Programet Festive të 28-29 Nëntorit

18. Klubi i Medias

19. Këndi i Shkrimit

20. Përfundoi sezoni i parë i GDS-ve

21. Oxford Placement Test

22. Ekskursion Në Vendlindje

23. Reklama 1

24. Piknikët

25. Fillojnë Pikniket

26. Poster 2 faqe

27. Në Muzeun Kombëtar

28. Në Muzeun Historik Kombëtar

29. Vizitë në Kalanë e Krujës

30. Reklama 2

31. Në Kinemanë Cineplex

32. Argëtohemi Në Kinema

33. Një Ditë e Veçantë Në Fermë

34. Pedalim Në Tiranë

35. Ekskursion Në Kopshtin Zoologjik

36. Ekskursion Te Liqeni

37. Klubi i Gatimit

38. Si Bëhet Reçeli

39. Turshi!

40. EDUKIMI I VLERAVE

41. Jo Alkoolit!

42. Lojrat e Inteligjencës

43. Të Mbrojmë Ozonin

44. Shëtitje në Bosnje

45. Shkolla Dimërore Në Londër

46. TOC Talks

47. Faqe 47 Te TANGRAMI Në "Ora News"

48. Diela Shqiptare

49. NjëVizitë e PaharrueshmeNë RTSH, KënaqësiDheEksperiencë...

50. Reklama

51. Në buletinin pasardhës

52. Kapaku mbrapa, Reklame

AL COLLEGE

95

ANË



KLUBI "SHPRESA"

Klubi "Shpresa" ka qenë shumë aktiv këtë periudhë të vitit shkollor duke nxjerrë në pah ndjeshmërinë dhe humanizmin e nxënësve të kolegnjit për njerëzit në nevojë. Duke e nisur punën me organizimin e panairove ushqimore ku krijohet fondi i nevojshëm për të siguruar ndihmat, klubi shpresa vijoi me aktivizimin e nxënësve vullnetarë në ndihmë të jetimëve, fëmijëve të martirëve të policisë së shtetit, fëmijëve me sëmundje të rënda si dhe bashkëmoshatarëve në disa shkolla në nevojë..



Shembull Për T'u Ndjekur, Nora Malaj

Znj. Nora Malaj, zëvendësministre e Arsimit dhe Sportit, u shpreh në një intervistë me Klubin e Medias të shkollës "Turgut Özal" gjatë vizitës në panairin ushqimor se shembulli i këtij panairi duhet të ndiqet nga gjithë shkollat e Shqipërisë.



Ministri Panariti në Panairin e Klubit "Shpresa"

Panairi i Ushqimeve është aktiviteti tradicional i përvitshëm i Klubit "Shpresa". Secili nxënës gatuan dhe shet ushqime dhe në këtë mënyrë krijohet fondi për ndihma. Këtë vit panairi u vizitua nga Ministri i Bujqësisë, Z. Edmond Panariti.

Ministri bisedoi me nxënësit e fillores për produktet e nxjerra në shitje. Vizita në panair u pasua me një bisedë me drejtorin e shkollës Z. Selman Fettahoğlu. Z. Panariti i propozoi drejtorit që një panair të tillë ta zhvillojnë pranë ministrisë që ai drejton.





PANAIR NË MINISTRINË E BUJQËSISË



Në përgjigje të ftesës së nga Ministrit Panariti shkolla jonë mori pjesë në një panair ushqimor në Ministrinë e Bujqësisë. Në bashkëbisedimin tij me nxënësit e kolegjit, ministri i këshilloi nxënësit se si të ushqehen në mënyrë të shëndetshme dhe të evitojnë atë që quhet “junk food”. Më pas u zhvillua një takim me shefin Sokol Prenga dhe dietologjen Enkelejda Ferrollari të cilët folën me fëmijët për ushqime që duhet të konsumojmë



Një Karrige Për Luizin

Klubi Shpresa gjatë një fushate ndihme në bashkëpunim me Shoqatën Kombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara u njoh me një djalë 7 vjec, i cili quhej Luiz. Ai ishte në një gjendje të keqe, karroca ishte e papërshtatshme për të, kështu që nxënësit e Klubit Shpresa i dhuruan një karrocë të re.





FËMIJËT ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Vullnetarët e "Shpresës" dhuruan dashuri dhe mbështetje edhe për Shoqatën Kombëtare të prindërve për kujdesin e fëmijëve me aftësi të kufizuara të Shqipërisë. Ata dhuruan 25 pako me ushqime, secila nga 15 kg.



KLUBI SHPRESA NDIHMA NË ZALLBASTAR

Shumëkush nuk e di se pas Malit të Dajtit gjendet një fshat që quhet Zallbistar. Me makinë, nxënësve të klubit Shpresa iu deshën plot një orë e gjysëm për të shkuar. Rruga ishte e lodhshme sepse ishte në gjendje shumë të keqe.

Në Zallbistar nxënësit e klubit Shpresa u takuan me familje të varfëra për t'u dorëzuar ndihma ushqimore. Gjithsej u dorëzuan 25 pako secila me nga 15 kg ushqime.

Nuk do ta harrojmë kurrë një nënë që kishte ecur dy orë në këmbë për të marrë një pako me ndihma. Kur pamë që pakoja ishte shumë e rëndë për të dhe s'mund ta çonte në shtëpi e pyetëm dhe fatmirësisht shtëpia e saj ishte në rrugën e kthimit dhe e ndihmuam të kthehej me makinën tonë.

Nuk do të harrojmë as një gjyshe që kishte ardhur në vend të së bijës e cila kujdesej për të shoqin e sëmurë ndërkohë që nuk kishte kush të kujdesej e të siguronte ushqim për tetë fëmijët e vegjël të tyre.

Zallbistarin e lamë pas, por lamë edhe ndihma. Si ky fshat ka plot të tjerë në nevojë dhe ne shpresojmë që t'i ndihmojmë sadopak edhe ata.





BUZËQESHJE PËR JETIMËT

Ndihma e klubit “Shpresa” mbërriti edhe te Shoqata Kombëtare e Jetimëve të Shqipërisë. Në 75 pakot që u dhuruan gjendeshin produkte ushqimore. Në fytyrat e vullnetarëve tanë lexohej dhembshuria dhe një buzëqeshje ngushëlluese.



NJË LIBËR PËR MIKUN TIM

Në spitalin pediatrik gjenden dhoma të përbashkëta pushimi ku fëmijët që po trajtohen nga sëmundje të rënda mund të kalojnë kohën duke lexuar libra.

Anëtarët e Klubit Shpresa e klasave të shtata, të vendosur për të ndihmuar në pasurimin e këtyre mini bibliotekave, duke shfrytëzuar Muajin e Artit dhe Letërsisë, me moton "Një libër për mikun tim", mbledhën libra, i paketuan së bashku me disa dhurata dhe vizituan spitalin pediatrik.

Rreth 40 fëmijë që janë duke u trajtuar tashmë mund të lexojnë disa nga titujt e zgjedhur nga bashkëmoshatarët e tyre të shkollës "Turgut Özal".



Miqtë e Librit

Në shkollën tonë është krijuar Klubi "Miqtë e librit". Ky klub ka si qëllim të nxisë nxënësit të lexojnë sa më shumë, pasi librat janë miqtë tanë më të qetë, këshilltarët më të mençur dhe mësuesit më të mirë.

Në këtë klub nxënësit bashkëbisedojnë për vepra të ndryshme, lexojnë si dhe realizojnë takime me autorët e librave më të dashur për ta. Aktivitetet e këtij klubi zhvillohen në bibliotekën e shkollës.





Panairi i Librit

Panairi i 18-të i Librit Tirana 2015-të, i cili është hapur në Pallatin e Kongreseve u vizitua dhe nga nxënësit e shkollës sonë, të cilët nuk i shpëtuan dot tundimit për të blerë sa më shumë libra. Ky panair është ngjarja më e madhe kulturore në pasqyrimin e veprimtarisë letrare brenda dhe jashtë kufijve të Shqipërisë. Panairi ka si qëllim paraqitjen e botimeve më të mira të hedhura në qarkullim në harkun kohor të një viti, nëntor 2014-nëntor 2015 dhe jo vetëm.



Vizitë në Bibliotekën Kombëtare

Nxënësit e Klubit “Miqhtë e Librit” vizituan Bibliotekën Kombëtare.

Gjatë bashkëbisedimit me specialisten e BKSJ-së ata mësuan si funksionon biblioteka, regjistrimi, shfrytëzimi i materialeve të fondit të saj, të sallave të leximit, aktiviteteve, etj. Interes ngjalli teknologjia në BKSJ, kërkimi on-line në faqen zyrtare të Bibliotekës si dhe Biblioteka Dixhitale.

“Miqhtë e Librit” janë duke promovuar në kolegjin “Turgut Ozal” dhurimin e librave për pasurimin e fondit të Bibliotekës së shkollës.



Nxënësit në Ministrinë e Integrimit Evropian

Ministrja, Ju Jeni e Ardhmja e Këtij Vendi

Gjatë një vizite në zyrat e Ministrisë së Integrimit Evropian, Ministrja Klajda Gjoshaj vlerësoi kolegjin “Turgut Özal” teksa bisedonte me nxënësit e klasave të shtata të kësaj shkolle.

Në faqen zyrtare online, ministria e ilustroi veprimtarinë duke u shprehur, “Ju duhet të investoni tek dija dhe arsimimi, pasi pa ju, pa të rinjtë nuk mund të kemi një Shqipëri europiane. Ju jeni e ardhmja e këtij vendi”.

Ajo i prezantoi nxënësit me punën që bëhet për procesin e integrimit dhe foli për reformat që ende duhen plotësuar.





Vizitë në Bashkinë e Kamzës

Vizita e radhës nga nxënësit e klasave të treta ishte Bashkia e Kamzës. Të shoqëruar nga përfaqësues të shkollës, shkuan në këtë bashki ku u pritën nga kryetari i saj z. Xhelal Mziu.

Gjatë bisedës që nxënësit zhvilluan me z.Mziu u njohën me funksionimin e pushtetit vendor, parimet e demokracisë në këtë nivel qeverisjeje, zhvillimet që janë bërë në këtë bashki dhe investimet e bëra në fushën e arsimit.

Më tej, nxënësit vizituan edhe sallën e Këshillit Bashkiak ku improvizuan një mbledhje.

Së fundi, kryetari i bashkisë, z.Mziu i nderoi vizitorët me një certifikate mirënjohjeje, në kuadër të bashkëpunimit në fushën e arsimit.

Vizitë në Kuvend

Nxënësit e klasave të treta vizituan ambientet e parlamentit, për të parë vendin ku hartohen dhe miratohen ligjet e shtetit shqiptar. Nxënësit u pritën nga deputeti Helidon Bushati si dhe punonjës të tjerë të parlamentit.

Fëmijët, kureshtarë për të ditur si zhvillohen mbledhjet në kuvend, nuk reshtnin së pyeturi për mënyrën e organizimit të tyre.

Disa prej nxënësve shfrytëzuan për pak minuta foltoren e Kuvendit për të vënë në pah oratorinë e tyre.





EKSKURSIONE NË VENDLINDJE

Për të konkretizuar njohuritë e marra në lëndën e Vendlindjes për historinë dhe kulturën e qytetit të Tiranës u organizua një ekskursion me nxënësit e klasave të pesta në disa nga objektet kryesore social-kulturore dhe mjediset arkeologjike dhe historike të qytetit të Tiranës.

Disa prej vendeve që vizituan ishin: Xhamia e Et'hem Beut, Kulla e Sahatit, Bashkia e Tiranës, Sheshi Skënderbej, Muzeu Historik Kombëtar, Hotel Tirana Internacional, Pallati i Kulturës, ministritë, Teatri i Kukullave, Banka Kombëtare Shqiptare, Banesa e Toptanasve, Kuvendi i Shqipërisë, Pedonalja, Galeria e Arteve, Kinema Millenium, Teatri Kombëtar etj si dhe Kodrat e Liqenit.



Muaji i Artit dhe Letërsisë

Muaji i Artit dhe Letërsisë, hapi si çdo tetor siparin e aktiviteteve kulturore në Kolegjin “Turgut Özal”. Konkurset e Fjalës Artistike, Krijimit, Këngës dhe Artit figurativ, janë nga veprimtaritë më të dashura për nxënësit gjatë këtij muaji.

Konkurset u zhvilluan në dy faza. Nxënësit që kaluan fazën finale, në secilën kategori, përfaqësuan shkollën në konkursin midis Kolegjeve Turke në Shqipëri.

Nxënësit u përballën në një garë të fortë mes njëri-tjetrit. Emocionet dhe ankthi për një përfaqësim sa më të mirë për veten, por edhe për shkollën ku studiojnë, ndiheshin te çdo konkurent.

Fituesit u vlerësuan me certifikata, shpërblime dhe fjalë inkurajuese nga organizatorët dhe juria.



Programet Festive të 28-29 Nëntorit

Një sërë koncertesh festive përmbyllën në mënyrën më të bukur të mundshme të gjitha veprimtaritë e organizuara nga shkolla jonë në kuadër të festave të 28 dhe 29 Nëntorit.

Vargjet kushtuar atdheut, heronjve, gjuhës sonë të bukur shqipe, lashtësisë në trojet tona, si dhe thëniet e personaliteteve botërore për Shqipërinë dhe shqiptarët, zgjuan te të pranishmit ndjenjën e krenarisë kombëtare dhe të atdhedashurisë. Kërcimet plot ritëm, këngët, videot me pamje nga të gjitha trevat shqiptare përcollën emocione te publiku.

Gjatë koncertit, përveç ngjyrave kuqezi, skena u vesh me larmishmërinë e kostumeve tona popullore që nga xhubleta e deri te fustanella, si dhe u mbush me tingujt e çiftelisë, ritmet e daulles dhe me magjinë e isos labe. Koncertet tona u nderuan nga pjesëmarrja e zëvendësministres së Arsimit dhe Sportit, znj. Nora Malaj, Zëvendës Ministrit të Kulturës z. Zef Çuni, Kryetarit të Qarkut të Tiranës z. Aldrin Dalipi, artisti i njohur Ardit Gjebrea etj.





Klubi i Medias

Klubi i medias, në të cilën marrin pjesë mësues të gjuhës shqipe, është një prej klubeve që vijon punën prej vitesh në shkollën tonë. Si rezultat i punës së këtij klubi botohen tre revista.

Këtë vit risi e këtij klubi është se janë pjesëmarrës edhe nxënësit, të cilët janë në rolin e gazetarit apo reporterit duke shfaqur talentet e tyre në këtë fushë. Një pjesë e mirë e shkrimeve në këtë buletin u punuan nga nxënësit. Ata janë pjesëmarrës në mbledhjet e klubit, marrin vendime së bashku me mësuesit, zhvillojnë intervista dhe aktivizohen në veprimtaritë e ndryshme të organizuara në shkollë dhe jashtë saj.



Këndi i Shkrimit

Në njërën prej ambienteve të shkollës zuri vend një prej risive të këtij viti shkollor sjellë nga mësuesit e gjuhës. Si pjesë e Muajit të Artit dhe Letërsisë nxënësit morën pjesë në veprimtarinë e quajtur "Këndi i Shkrimit".

Çdo nxënës pati mundësi të shkruante vazhdimin e një tregimi të nisur duke shtuar diçka nga fantazia e vet, por pa e përfunduar atë, në mënyrë që vijimin ta shtonin shokët apo shoqet e tjera. Përfundimi do të jetë një libër i shkruar nga vetë nxënësit, ku ide e imagjinata të ndryshme të ndërthuren me njëra-tjetrën, duke krijuar kështu një histori tepër interesante.

Përfundoi sezoni i parë i GDS-ve

Përfundoi sezoni i parë i GDS-ve. Për këto provime nxënësit u praktikuan në faqen zyrtare tirana.turgutozal.edu.al, në profilin personal të tyre dhe në portalin Test Yourself.

Këto provime u zhvilluan në të gjitha lëndët duke përfshirë temat e zhvilluara gjatë 8 javëve të para të vitit shkollor.


Këto teste janë një tregues i nivelit të zotërimit të njohurive nga ana e nxënësve në të gjitha shkollat turke në Shqipëri.





Oxford Placement Test

Në shkollën tonë prej kohësh ka nisur njehsimi i nivelit të anglishtes me provimendërkombëtare. Të gjithë nxënësit i nënshtrohen testimit të nivelit të gjuhës nga Oxford. Rezultatet e nxjerra nga ky test përdoren për të planifikuar hapa të mëtejshëm në mësimdhënien e gjuhës angleze por edhe për provimet shtetërore si çështje ai i lirit në përfundim të klasës së nëntë. Secili nxënës bën dy testime të tilla në vit për të përcaktuar nivelin me të cilin e nis një vit shkollor si dhe nivelin me të cilin e përfundon.





Piknik Në Pezë

Pikniket janë aktiviteteve më të shumëpritura në shkollën tonë. Duke shpresuar edhe për mot të mirë, bashkë me nxënësit dhe mësuesit pritej të kalonim momente të mbushura me lojra dhe argëtim në natyrë.

Dhe në fakt ajri i pastër, gjelbërimi i parkut në Pezë, lojrat me shokët e shoqet, kujtimet e mbërthyer në fotografi ua rifreskuan energjitë nxënësve para se të nisnin provimet e përgjithshme GDS





Ashtu si dhe është bërë traditë piknik u organizua në Pezë. Çdo paraleli të fillores i ishte caktuar një ditë e veçantë për t'u nisur drejt këtij fshati turistik. Nxënësit zhvilluan mjaft lojëra argëtuese, si: loja me litar, lojëra me top, lojëra popullore, gara shpejtësie, kalim pengesash etj. Ajo që e bëri më të veçantë shëtitjen ishte përgatitja e ushqimit në piknik.





Që Jeta e Çdo Nxënësi Të Jetë Festë, Shkolla Kthehet Në Shenë.



NË MUZEUN KOMBËTAR

Drejtorja e shkollës organizoi për fëmijët e kopshtit një ekskursion në Muzeun Kombëtar për të parë nga afër objekte e dokumente të rëndësishme në historinë e popullit shqiptar.

Fëmijët preknin dhe pyesnin për çdo gjë që shikonin. Ishin kuriozë të shihnin heronjtë kombëtarë për të cilët kanë dëgjuar dhe u është folur shumë.




N ë M u z e u n Historik Kombëtar

Një vizitë tepër interesante ishte edhe ajo në Muzeun Historik Kombëtar. Nxënësit u njohën nga afër me historinë e popullit shqiptar në pavionet e muzeut që nga Periudha Parahistorike, Antikiteti, Mesjeta e deri në Periudhën e Rilindjes Kombëtare, Shpalljes së Pavarësisë dhe vendosjes së Regjimit Komunist në Shqipëri.

Aty panë mënyrën e jetesës së popullit tonë ndër shekuj si dhe ndikimet e kulturave të popujve të tjerë.

Gjithashtu u prezantuan me mënyrat e ndryshme të qeverisjes dhe organizimit të shtetit, që nga Periudha e Mesjetës e deri në shekullin e 20-të dhe rolin e personaliteteve e figurave të politikës dhe kulturës në këtë qeverisje.







Vizitë në Kalanë e Krujës

Gjatë nëntorit, muajit të Festave Kombëtare, nxënësit e klasave të 7-ta zhvilluan një ekskursion në qytetin historik të Krujës.

Ata vizituan Muzeun Historik të Krujës dhe pazarin karakteristik të qytetit, i cili mbart shumë tradita të përcjella brez pas brezi.

Punimet artizanale dhe suvenirët karakteristike krutane tërhoqën vëmendjen dhe kuriozitetin e nxënësve, duke u bërë kështu pjesë e bukurisë së kësaj shëtitjeje. Me zërat gazmorë, nxënësit tanë ia shtuan gjallërinë rrugicave që mbartin historinë.





N ë Kineman ë Cineplex

Nxënësit e klasave të katërta dhe të pesta shkuan në Kinema Cineplex për të parë filmin "Princi i lumtur".

Gjatë kohës që priteshin biletat, nxënësit bënë fotografi me disa ikona të kinemasë në kartona, gjë që i zbaviti pa masë.

Nxënësit e endoqën filmin me shumë interes. Rugës së kthimit ata ende diskutonin rreth tij



Argëtohemi Në Kinema

Një ditë ndryshe ishte dhe eskursioni me grupet parashkollore në kinemanë 3D në një prej qendrave tregtare të Tiranës.

Fëmijët të lumturuar ndoqën dy filma me minutazh të caktuar, por më i pëlqyeshmi për ta mbeti filmi “Dinosauri i mirë”.

Fëmijët shikonin të mahnitur nga filmat me pamje tredimensionale i vazhduan diskutimet edhe pas mbarimit të tyre.







Një Ditë e Veçantë Në Fermë

Një ditë e veçantë në fermën e Anës dhe Dinit si surprizë e shokëve dhe shoqeve për ditëlindjen e Anës. Ata i dhanë asaj dhuratat e tyre ndërkohë që shijonin ushqimet e gatuar me produkte të marra pikërisht nga kjo fermë.

Gjërat më të bukura që duan fëmijët janë lojrat në ajër të pastër, ku ata vraponin pa pushim.





Pedalim Në Tiranë

Një ditë me biçikleta për nxënësit e kolegjit për të mbështetur nismën e bashkisë “Tirana pa makina” ishte aktiviteti që u zhvillua me nxënësit e klasave të shtata në kodrat e liqenit artificial të Tiranës.

Në koshat e biçikletave nxënësit kishin vendosur shprehje për këdo që do t’i vinte re.

“Mbani pastër qytetin”si dhe “Stop obezitetit” ishin disa prej tyre.

Kyaktivitetsynontëpromovojëtek nxënësit përdorimin e biçikletave. Në këtë mënyrë, jo vetëm që do të jemi më të shëndetshëm dhe në formë por ndihmojmë qytetin tonë në reduktimin e përdorimit të makinave.

Promovimi i këtij sporti kaq social u jep një alternativë tjetër fëmijëve kundrejt lundrimit në internet apo orëve të gjata para televizorit.





NË KOPSHTIN ZOOLOGJIK

Fëmijet e kopshtit "Zübeyde Hanım" shkuan në ekskursion në kopshtin zoologjik, ku u njohën nga afër me kafshët dhe shpendët që gjenden atje.

Fëmijët shikuan nga afër ariun, ujkun, dhitë, lamat, dhelpërën, shqiponjën, bufin, lepurin, macen e egër, më pas shikuan pulat që kullotnin në bar, patat dhe mjelmat që notonin në ujë.

Në sytë e shumë prej fëmijëve shikoje habi, pasi po i shikonin këto kafshë jashtë televizorit apo librave.

EKSKURSION TE LIQENI

Për të parë më nga afër stinën e vjeshtës fëmijët e grupeve të treta organizuan një ekskursion tek kodrat e liqenit artificial. Fëmijët vëzhguan nga afër ngjyrat e gjethëve në këtë stinë dhe me gjethet e grumbulluara punuan aplikacion me temën "Gjethet në vjeshtë".


Më tej u zhvilluan lojra argëtuese me balona, me shami, lojra shpejtësie, etj



Klubi i Gatimit

Krahas klubeve të njohura, ky vit solli edhe hapjen e më të riut prej tyre, Klubin e Gatimit, i cili ofron një mundësi më shumë për nxënësit që janë të dhënë pas artit të kulinarisë.

Në dispozicion të këtij klubi janë vënë ambiente të veçanta gatimi, të cilat janë pajisur me mjetet e nevojshme për të gatuar. Fillimisht nxënësit praktikuan pjata të thjeshta, por me ndihmën e mësueseve ata tani janë në gjendje të përgatisin gatime të shumëllojshme.





Turshi!



Është viti i dytë që nxënësit e kopshtit përgatisin turshi. Fëmijët të lumtur sollën lakra, karrota, specia, domate dhe filluan përgatitjet duke i prere dhe përzier gjithë gëzim me kripë dhe ujë dhe i fushin nëpër kavanoza.

Si Bëhet Reçeli

Fëmijët e grupit të Mjelmave, Dallëndysheve, dhe Frutave kaluan një ditë shumë të veçantë në kuzhinë, ku “shefat” e vegjël përgatitën reçel ftoi.

Receta është ajo e hershmja që përgatisnin nënat tona për stinën e dimrit. Ftonjtë u lanë, u qëruan, u prenë në copa të vogla (disa prej të cilave i hëngrëm fëmijët), pastaj u shtua dheqeri dhe pak ujë. Kjo përzierje u la të ziete dhe në fund u bë prova e cilësisë nga “shefat”.





EDUKIMI I VLERAVE


Në shkollën tonë klasat e para, të dyta dhe të treta kanë filluar aplikimin e programit të “Edukimit të Vlerave”. Edukimi i vlerave është një sistem edukimi i cili gjen fillimet e tij në vitin 1995 dhe tashmë i përhapur në shumë vende të botës ju ofron mësuesëve metoda dhe mënyra praktike për të ndihmuar fëmijët të zhvillojnë vlerat e tyre personale dhe ato sociale. Ky sistem edukimi, qëllim kryesor i të cilit është rritja e individëve të dobishëm për veten dhe shoqërinë, gjen mbështetje nga organizata si UNESCO dhe Association for Living Values Education International (ALIVE).

Çdo javë, në lidhje me tema të ndryshme edukative si “Laj duart”, “Mbaj pastër trupin tim”, “Mirëmbajtja e Librave”, “Rregullat e Mirësjelljes në tryezë”, “Pres radhën për të folur” e të tjera e të tjera, janë zhvilluar aktivitete praktike, kemi dizenuar dhe pasuruar këndin e klasës me njohuri


rreth këtyre vlerave, kemi ndjekur video edukative në orën e kinemasë, mësuesja jonë na ka lexuar tregime interesante si dhe kemi ndjekur fjalimet e shokëve tanë në TOC talks.

Vlerat shoqërore dhe individuale, përbëjnë aspektet më të rëndësishme të jetës së njeriut. Dashuria, kurajoja, miqësia, bashkëpunimi, pastërtia, respekti, integriteti, mirësia janë vlerat shoqërore të cilave u kemi dhënë dhe vazhdojmë t’u japim rëndësi.

Vlerat janë të rëndësishme për shoqërinë, për këtë arsye njerëzit të cilët veprojnë në përputhje me vlerat e shoqërisë janë të vlefshëm për të.



JO ALKOOLIT! SEMINAR ME POLICINË E SHTETIT



Policia e shtetit zhvilloi një seminar mbi konsumimin e pijeve të dëmshme në kolegjin "Turgut Özal".

Ky seminar u zhvillua me klasat e gjashta. Qëllimii tij ishte që nxënësit të informohen në mënyrë të detajuar mbi pasojat që sjell përdorimi i këtyre pijeve, sidomos alkoolit. Më tej, ata u njohën gjerësisht me dëmet që shkakton konsumimi i pijeve alkoolike dhe pamundësia për t'i shmangur ato, nëse tek përdoruesit krijohet vartësi.

Theksi u vu edhe tek domosdoshmëria e informimit sa më herët për adoleshentët në mënyrë që të mos bien pre e tij.

Lojrat e Inteligjencës

Finalja e Jengës Dhe Mangalës

U zhvilluan në oborrin e shkollës lojërat e inteligjencës Jenga dhe Mangala.

Nxënës nga shkolla "Turgut Özal" të klasave të 7, 8 dhe 9 një mëngjes me diell të shtune preferuan ta kalojnë me shokët e shoqet në shkollë duke konkuruar në lojra të ndryshme sociale.

Sot është dita e finales për këtë kategori brenda shkollës sonë. Nxënësit fitues do të konkurojnë me ata të shkollave të tjera turke në Shqipëri.



Të Mbrojmë Ozonin

“Turgut Özal” vlerësohet me Kupën e Ozonit 2016

Dita ndërkombëtare e ozonit u celebrua në shkollën tonë duke organizuar një ekspozitë me rreth 150 piktura të nxënësve si dhe duke kënduar këngën “Ozone Song”, kënga e ozonit.

Aktiviteti ishte bashkëpunim i drejtorisë së shkollës dhe Njesisë Kombëtare të Ozonit (NKO) me ndihmën e mësueses së artit figurative Afërdita Riveni si dhe mësuesve të muzikës Dritan Vasili dhe Fjorin Veliu.

Veprimtaritë u hapën me prezantimin e përfaqësueses së NKO-së, Znj. Silvana Delia, dhe vijuan me përzgjedhjen e pikturave më të arrira. Vend i parë u fitua nga nxënësi Ergi Çoku.

Nxënësve u shpërndanë certifikata ndërsa shkolla “Turgut Özal” u vlerësua me Kupën e Ozonit 2016.





Shëtitje në Bosnje

Shëtitja në Bosnjë gjatë muajit nëntor ishte një çlodhje për nxënësit e klasave të katërta dhe të pestë, të cilët kaluan atje 3 ditë që do i mbajnë mend gjatë.

Nxënësit kaluan momente të gëzueshme, shijuan mundësitë e turizmit që ofron Bosnja dhe u njohën me pjesëza të historisë të mbetura në muret e shtëpive si kujtesë kolektive e banorëve të atjeshëm.

Disa prej stacioneve turistike që u vizituan përfshijnë: Urën e Mostarit, Pazarin e famshëm Bashçarshija dhe Parkun "Vrelo Bosne".





Shkolla Dimërore Në Londër

Shkolla "North London Grammar School" priti nxënësit e klasave të gjashta gjatë nëntë ditëve të shkollës dimërore. Gjatë paradites, nxënësit zhvilluan orë mësimi mjaft zbavitëse në gjuhën angleze me mësues vendas, ndërsa pasditet përfshinin shëtitje dhe argëtim nëpër qytet. Nxënësit vizituan pikat kryesore turistike të qytetit si: London Eye, London Bridge, Tower Bridge, Buckingham Palace; muzeun e Shkencës, të Natyrës dhe muzeun e famshëm Madame Tussauds. Gjithashtu, një vend të veçantë në këtë shkollë dimërore zuri shëtitja në qytetin e vjetër të dijes, Oxford City.





TOC Talks

TOC Talks është një nismë e shkollës sonë për të nxitur nxënësit të shprehin mendimet dhe argumentet e tyre në lidhje me një temë që ata e shohin si të rëndësishme. Në të mund të marrin pjesë nxënësit e të gjithë klasave duke folur para një publiku të zgjedhur nga ata vetë, ku mund të ketë: bashkëmoshatarë, prindër, drejtues etj.

Shumë fjalime janë bërë të cilat mund të ndiqen në kanalin youtube TOC Talks. Besojmë se edhe ju do të surprizoheni nga klubi i oratorëve të së ardhmes!





Te TANGRAMI Në "Ora News"

Dy nxënëse të shkollës sonë kanë konkuruar në emisionin "Tangram" në Ora News dhe kjo u bë shkas për një vizitë të senatorëve të shkollës në studiot e këtij televizioni.

Qëllimi i Tangramit, sipas drejtuesve të emisionit, është që t'u kushtohet kohë fëmijëve dhe kërkesave që kanë ata. Filozofia mbi të cilën ngrihet ky emision është që fëmijët mund ta bëjnë Shqipërinë më të mirë.


Konkurentet nga shkolla jonë ishin: Kayceety Mullaj, me projektin "Pyetjet i bëj unë" dhe Jona Nuredinaj, me projektin "Mbledhja e tapave që të blejmë karrocë për njerëzit me aftësi të kufizuara".

E Diela Shqiptare

Dy nxënës të kolegjit “Turgut Özal” u kualifikuan për në finalen e madhe të emisionit popullor Power Kidz. Amina dhe Amiri, të dy nxënës në klasën e katërt, nuk lanë mëdyshje për jurinë e konkursit për fëmijë që zhvillohet në televizionin Klan gjatë emisionit “E diela shqiptare”. Konkursi final i talenteve të këtyre fëmijëve do të zhvillohet në prill.





Një Vizitë e Paharrueshme Në RTSH, Kënaqësi Dhe Eksperiencë



Nxënësit e klasës së 8-E zhvilluan një vizitë në studiot e Radio Televizionit Shqiptar. Ata u njohën me figurat kryesore që hodhën themelet e këtij institucioni dhe panë fotot e momenteve më kulminante të arrira në 55 vite pune. Gjithashtu u njohën dhe me kamerat, aparatet fotografike dhe televizorët e parë, të ruajtura si dëshmi historike në një minimuze brenda godinës.

Nxënësit panë sallat ku xhirohen emisione të ndryshme dhe u njohën me punën e padukshme të pjesës tjetër të stafit, të cilët merren me ndriçimin e dekorin e studiove për realizimin e emisioneve të shumta. Ata ndoqën drejtpërsëdrejti edicionin informativ të lajmeve nga dhoma e e regjistrimit si dhe u bënë dëshmitarë të tingujve të mrekullueshëm të interpretuara mjeshtërisht nga instrumentistët e talentuar të orkestrës.





Në Buletinin e Ardhshëm Do Të Gjeni

1. Ski Në Bursa
2. Shëtitje Në Evropë
3. Tirana Bardhë e Zi
4. Destinacioni Evropa
5. Festivali Ndërkombëtar
I Gjuhës Dhe Kulturës
6. Festat e 7 Dhe 8 Marsit
7. Oxford Placement Test 2
8. Provimet KET Dhe PET
9. Sërish GDS
10. ASEF
11. Olimpiadat Shkencore
EPOKA
12. Festojmë Një Lëndë Çdo
Javë
13. Talentet e Fillores Bëjnë
Shoë
14. Eskursione!
15. Festa e Abetares
16. Festat e Klasës
17. Minimatura
18. Piknik Pranveror
19. Kampionatet Sportive
20. Edhe Shumë Të Tjera ...



*me rritjen me te madhe
ne tregun e sigurimeve*



Mercedes-Benz

The best or nothing

AUTO STAR ALBANIA

Autostrada Tiranë-Durrës tel: +355 44 500 333 email: info@autostar.al
Km.7, Kashar, Tiranë fax: +355 44 500 333 web: ww.autostar.al

25% ULJE
për pjesët e këmbimit



40% ULJE
të kohës së punës



PJESË E
KASTRATI GROUP